

LEXIMI DHE KOMUNIKIMI NDËRNJERËZOR

Leximi është mjete më i sigurt dhe më i dobishëm i shoqërizimit të njerëzve, është gurthemel i qytetërimit dhe mjete më i përsosur i komunikimit kulturor dhe ndërnjerëzor. Ka një lidhje të drejtpërdrejtë mes leximit dhe zhvillimit në të gjitha shfaqjet e tij, duke përfshirë edhe anën ekonomike. Një shoqëri që lexon, nuk mund të jetë e varfër. Aty ku lexohet më shumë, aty jetohe më mirë, aty njeriu vetërealizohet më mirë, e përmbush misionin dhe funksionin e tij si qenie më mirë dhe më plotësisht sesa tjetërkund. Të para në këtë këndvështrim, problemet e botës sot, ashtu sikurse dje, nuk janë probleme të zhvillimit, por të leximit.

Bota e zhvilluar, në të vërtetë dhe në thelb, është botë e lexuar. Vendet e botës që vuajnë nga problemet e zhvillimit të ulët ekonomik, nuk mund të kapin ritmin e zhvillimit pa masivizuar kulturën e leximit. Raporti midis varfërisë dhe leximit është një lidhje e zhdrejtë, e përhershme, e dëshmuar dhe e vërtetuar historikisht. Afrika është pjesa e botës që e shembullon lidhjen që ekziston mes mungesës së leximit dhe mungesës së zhvillimit. Është kontinenti më i pasur në burime natyrore. Është po ashtu edhe kontinenti më i vjetër dhe djepi i njerëzimit. Është copëtoka me kushtet më të favorshme klimatike për mirëqenien e njeriut. Aty, në dallim nga të gjitha kontinentet e tjera, nuk ekziston dimri si stinë. Është pranverë dhe verë e përjetshme. Është edhe copëtoka më e qëndrueshme në pllakat tektonike të tokës. Aty ndodhin më pak tërmete, vullkane, uragane dhe fatkeqësi natyrore sesa në pjesët e tjera të botës. Edhe nëntoka e saj është më e pasura nga të gjitha kontinentet e tjera. Megjithatë është më pak i zhvilluari kontinent në rruzullin njerëzor. Nuk ka asnjë dyshim në aftësitë e njerëzve nga ky kontinent për zhvillim e qytetërim. Ata janë ndërtuesit e mrekullive të qytetërimit Evropian dhe të Amerikës, përveçse ndërtuesit e qendrave të ndryshme të qytetërimit, nga më të pasurat dhe më të lashtat në historinë e njerëzimit. Asgjë nuk i mungon Afrikës së madhe dhe origjinale për të qenë e zhvilluar dhe e përparuar si zonat e tjera të botës, përveç leximit. Asgjë nuk u mungon as *afrikave të vogla* të shpërndara anekënd botës, përveçse kryefjalës dhe kryeçelësit të zhvillimit dhe përparimit: leximit.

Duhet theksuar se leximi në vetvete ka pasur përherë e do të ketë përherë kundërshtarët dhe dyshimtarët e vet. Si çdo pasuri, si çdo vlerë, si çdo gjë e çmuar edhe leximi ka rënë pre e manipuluesve, falsifikatorëve dhe përçudnuesve. Sikurse në rastin e monedhave dhe të kartëmonedhave, që, sa më e madhe të jetë vlera e tyre, aq më e madhe është përpjekja e falsifikuesve për të krijuar monedha false, edhe leximi duke qenë gurthemeli dhe gur i çmuar i kulturës dhe qytetërimit, ka qenë e do të jetë pikësynim i manipuluesve. Krejt normale kjo, edhe pse jo e bukur dhe as e drejtë. Asnjë manipulues nuk përpiqet të falsifikojë qindarkat, por shumëkush prej tyre ëndërron të falsifikojë kryeveprat.

Që leximi të jetë gur i çmuar, që këshilla për lexim të jetë dobiprurëse, duhet që leximi të jetë i lirë, i pavarur dhe i paideologjizuar. Leximi nuk ka pse të jetë në shërbim të asgjëje, sepse është shërbim në vetvete. Ashtu sikurse përhapja e monedhave të falsifikuara në një ekonomi çon drejt krizës financiare, përhapja e falsifikimit të leximit çon në varfërimin e gjithanshëm të shoqërisë.

Përballja mes dy blloqeve të mëdha gjeopolitike gjatë Luftës së Ftohtë ishte përballje mes dy mënyrave të leximit, më shumë se sa mes dy mënyrave të zhvillimit. Të dhënat e fundit mbi renditjen e universiteteve në botë e dëshmojnë qartë këtë situatë. Asnjë prej vendeve të ish-blokut lindor në Evropë nuk ka ndonjë universitet brenda grupit të treqind universiteteve më të mira në botë.¹ Kjo

¹ <https://www.timeshighereducation.com/world-university-rankings/2018>. Ndërkohë që në këtë listë përfshihen universitete nga vende si Brazili, Arabia Saudite, India, Zelanda e Re, Singapori, Afrika e Jugut, Turqia, Emiratet e Bashkuara Arabe, Irani, Izraeli, Korea e Jugut, Kina, Malajzia, Uganda, Jordania, Pakistani, Katari, Tajvani. I pari universitet nga blloku i vendeve ish-komuniste të Europës, del Universiteti i Tartus (Estoni) vetëm në nivelin 301-350. Në këtë renditje universiteti i parë edhe nga blloku lindor jashtëeuropian, është ai Lomonosov i Moskës, që del në vendin e 199. Në renditjen tjetër të QS World University Rankings, nga vendet e ish-blokut lindor në Evropë nuk ka asnjë brenda 300 universiteteve më të mira. I pari që del nga kjo listë, është Universiteti Pragës, i renditur në vendin e 317.

<https://www.topuniversities.com/university-rankings/world-university-rankings/2019>. Ngjashëm edhe renditja e tretë për nga rëndësia, e realizuar nga Universiteti i Shangait, i lë jashtë universitetet e ish-blokut lindor në Evropë. Universiteti i Tartus në Estoni renditet edhe këtu në nivelin 301-400. Nga ana tjetër, vetëm sipas kësaj renditjeje, Universiteti i Pragës futet në nivelin 201-300. <http://www.shanghairanking.com/ARWU2018.html>

është pasojë e drejtpërdrejtë e falsifikimit dhe e përçudnimit të leximit në këto vende. Është pasojë e keqpërdorimit të leximit për të ngritur e forcuar kulte dhe jo për të kërkuar dhe krijuar kulturë. Sa më shumë ideologjizohej leximi në bllokun lindor komunist aq më shumë varfërohej kultura, dhe aq më shumë ngecte zhvillimi shoqëror. Sa më të fuqishëm bëheshin kundërshtarët, dyshimtarët dhe falsifikatorët e leximit në gjysmëbotën komuniste, aq më e madhe bëhej prapambetja kulturore dhe vendmbetja ekonomike e shkërmoqja shoqërore. Varfëria dhe varfërimi, të cilat shqiptarët i përjetojnë tash dy shekuj dhe që u kurorëzuan me krizën e thellë ekonomike të viteve 1980-1990, por edhe me lëngimin e ekonomisë pas vitit 1990 e deri më sot, janë krizë e leximit. E gjitha kjo është pasojë e leximit të paktë, të mangët, të vëngërt dhe të verbër.

Aspekt i rëndësishëm në vlerësimin e rëndësisë së leximit në traditën dhe kulturën e një shoqërie është zgjerimi i konceptit të kulturës dhe qytetërimit përtej mbitheksimit të kulturës erudite dhe kufizimit të qytetërimit në raste të kufizuara, të rralla dhe për më tepër të shkëputura në kohë produktesh të erudicionit kulturor e dituror. Në rastin shqiptar keqleximi i historisë ka krijuar idenë jo të saktë se shqiptarët nuk kanë pasur kulturë erudite deri në fillimet e përdorimit të shkrimit shqip. Mungesa e teksteve të shkruara në gjuhën shqipe deri në Kohën e Re, nuk nënkupton mungesën e kulturës erudite, as mospërdorimin e gjuhës shqipe si mjet komunikimi dhe transmetimi të kulturës dhe të qytetërimit. Analfabetizmi në një gjuhë të caktuar, në këtë rast e kemi fjalën për gjuhën amtare, nuk mund të konsiderohet si mungesë e kulturës erudite. Mungesa e gjuhës së shkruar nuk mund të lexohet si mungesë e kulturës. Kultura dhe kontributi për qytetërim mund të ekzistojë edhe në rastin kur gjuha e shkruar nuk është e njëjtë me gjuhën e folur.

Ky këndvështrim do të zgjeronte shumëfish diapazonin e kulturës dhe të qytetërimit shqiptar, duke përfshirë një numër shumë të madh veprash diturake dhe dorëshkrimesh të shkruara, të porositura apo të sponsorizuara nga shqiptarët, krahas librave apo dorëshkrimeve të shkruara në shqip. Autorë shqiptarë kanë lënë vepra madhore të kulturës botërore të shkruara në gjuhë të ndryshme mesdhetare dhe evropiane. Në këtë kategori, kemi vepra gjeografike dhe hartografike të konsideruara si trashëgimi e kulturës botërore nga UNESCO, traktate filozofike të botuara

dhe të përkthyer në gjuhë të ndryshme, vepra historiografike, projekte arkitekturore, të cilat mund të qëndrojnë përkrah dhe të pasurojnë qytetërimin që përcillet përmes veprave me karakter gjuhësor dhe letrar të shkruara në gjuhën shqipe, qoftë me alfabet latin, osman apo grek.

Kështu do të kuptonim edhe arsyet se përse zhvillimin e shkrimit në gjuhën shqipe nuk e kemi shfrytëzuar për t'u zhvilluar, por kemi mbetur prapa të tjerëve dhe përse leximin e kemi falsifikuar dhe përcudnuar, duke krijuar kulte e idhuj dhe jo duke lëvruar dijet e kulturën. Ky është hapi i parë dhe kryesor drejt zhvillimit. Është mënyra më e sigurt për të ecur krah të tjerëve dhe jo pas tyre.